




|   |  |
|---|--|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |  |
| Rep.<br>Llog.<br>Urgj.<br>Nr. i titullit<br>Shprehja e parësia<br>Nr. pages                                 | 2-D/DPK<br>Nr. Prot.<br>Bil. Prot.<br>Prot. No. 01-1252/13<br>Data<br>Datum 24-04-2013<br>Date |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.03.2013, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-243\13, për zyrtarin e lartë z. Kurtesh Sherifi, anëtar i Këshillit Shkencorë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-237/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Kurtesh Sherifi, anëtar i Këshillit Shkencorë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar dhe pronarit në biznesin privatë "Vac" SH.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.02.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Kurtesh Sherifi, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës me datën 05.03.2013, është organizuar takimi me z. Sherifi, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë

takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e anëtarit të Këshillit Shkencorë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, dhe ka të regjistruar një biznes me emër "Vac" SH.P.K .

ku është bashkëpronarë dhe person i autorizuar, mirëpo nuk ushtron aktivitet, por e ka regjistruar për shkak të trajnimeve që ka mbajtur dikur.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se në afat sa më të shpejtë do të bëjë ndryshimet e kërkuara dhe do ta shmang çfarë do situatë që mund të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari I lartë me datën 18.03.2013, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bërë ndryshimet dhe nuk është me pjesë e biznesit, as si aksionar dhe as si person i autorizuar.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z. Kurtesh Sherifi, si dhe në gjendjen faktike që gjendet zyrtari tash konstatohet se :

Zyrtari i lartë z. Kurtesh Sherifi, anëtar i Këshillit Shkencorë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej pasi që ka bërë ndryshimet e kërkuara dhe nuk gjendet në situatë të papajtueshme me Funksionin e tij Publik si anëtar i Këshillit Shkencorë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

